



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52. 2 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 7 prill 2011, pas shqyrtimit të propozimeve të grupeve parlamentare të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së, nxori këtë:

REZOLUTË

Në mbështetje të Memorandunit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahjen e tij për Memorandumin e Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi (më tej Memorandumi), të arritur më 6 prill 2011 dhe mbështetë plotësisht zotimet e përmbajtura në të.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështetë afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështetë themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga koalicioni qeverisës, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacionit të ndërlidhur, që mes tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë. Kuvendi mbështetë themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit i identifikuar nga partitë opozitare, për këtë qëllim ashtu siç është paraparë në

Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandum, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 8-12 muajsh nga data e themelimit.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë afatin kohor të përmbajtur në Memorandum sipas të cilit zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë sipas Ligjit të amendamentuar për Zgjedhjet e Përgjithshme do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë themelimin e komisioneve të lartëpërmendura, të nevojshme për proceset kushtetuese dhe legjislative në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nr. 04 - R -02
Prishtinë, më 7 prill 2011

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Rezoluta i dërgohet:

- Presidentes së Kosovës,
- Grupeve Parlamentare,
- Qeverisë së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.